

Flexible Travel Partner

Kushtet e shërbimit janë si më poshtë:

1. Ky shërbim kryhet kundrejt pagesës së [tarifës përkatëse të Flexible Travel Partner](#) për fluturim, për pasagjer. Shërbimi Flexible Travel Partner paguhet gjatë kryerjes së rezervimit për ju vetë dhe bashkudhëtarin tuaj të paemërtuar. Çmimi i biletës dhe tarifat e të gjitha shërbimeve për të gjithë pasagjerët paguhen gjatë rezervimit. Tarifa Flexible Travel Partner nuk është e rimbursueshme.
2. Ky shërbim ofrohet vetëm nga interneti dhe për ta përdorur duhet të identifikoheni në faqen wizzair.com.
3. Gjatë kryerjes së një rezervimi, nuk ka nevojë të përcaktoni emrat e bashkudhëtarëve tuaj, mjafton të jepni emrin e të paktën njërit pasagjer të rezervimit. Rezervimin nuk e përfundoni dot pa emërtuar asnjërin prej pasagjerëve.
4. Shërbimi ofrohet vetëm nëse gjatë rezervimit zgjidhni opsionin e checkin-it në internet (përveç GO dhe Plus Fare, shihni paragrafin 10 më poshtë).
5. Ky shërbim nuk ofrohet në rastin e foshnjave apo të pasagjerëve që kanë nevojë për asistencë të posaçme. Nëse udhëtoni me foshnjë, duhet të jepni emrin e foshnjës gjatë kryerjes së rezervimit.
6. Ky shërbim ofrohet vetëm përpara përfundimit të rezervimit. Pasi përfundimit të rezervimit nuk e zgjidhni dot shërbimin Flexible Travel Partner.
7. Nëse nuk e keni zgjedhur shërbimin Flexible Travel Partner dhe dëshironi të ndryshoni emrat e bashkudhëtarëve tuaj pas përfundimit të rezervimit, duhet të jepni emrat e bashkudhëtarëve tuaj të rinj dhe të paguani [tarifën përkatëse për ndryshimin e emrit](#)
8. Emrat e bashkudhëtarëve tuaj mund t'i shtoni duke hapur rezervimin dhe duke plotësuar emrat që mungojnë përpara checkin-it. Bashkudhëtari juaj mund ta kryejë checkin-in vetëm pasi është dhënë emri për të. Vini re se nëse nuk jepni emrat e asnjërit prej bashkudhëtarëve Flexible Travel Partner, do ta konsiderojmë këtë si anulim të rezervimit nga ana juaj për sa i përket partnerit të paemërtuar të udhëtimit.
9. Pasi të keni kryer checkin-in dhe nëse dëshironi të ndryshoni emrin e bashkudhëtarit tuaj, duhet të paguani [tarifën për ndryshimin e emrit](#)
10. Nëse zgjidhni GO Fare dhe Plus Fare dhe blini edhe shërbimin Flexible Travel Partner, checkin-in mund ta kryeni në aeroport. Gjithsesi, emrat e bashkudhëtarëve Flexible Travel Partner duhet t'i jepni nga interneti duke e hapur rezervimin jo më vonë se tri orë përpara nisjes së planifikuar të fluturimit tuaj. Nëse emrat që mungojnë nuk i plotësoni sipas përcaktimit më lart, kjo do të konsiderohet si anulim nga ana juaj i rezervimit për pasagjerët e paemërtuar.
11. Për të gjitha çështjet që nuk rregullohen në këtë dokument zbatohen kushtet e përgjithshme të transportit.
12. Transferta bankare nuk ofrohet për pagesën e rezervimit nëse zgjidhni shërbimin Flexible Travel Partner.
13. Ky shërbim nuk ofrohet për rezervime në grup.

Me blerjen e këtij shërbimi ju bini dakord të respektoni kushtet e mësipërme.